



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR VJOSË

Nr 18 / Prot
6

Vlorë, më 03 . 10 . 2023.

VENDIM

Nr. 8 , datë 28.09.2023

PËR

**MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR PËR UJË TË
AMBALAZHUAR, TË SUBJEKTIT “DG” SH.P.K ME VENDNDODHJE: FSHATI
TATZAT, NJ.ADM VERGO, BASHKIA DELVINË, QARKU VLORË**

Në mbështetje të shkronjës “b” të pikës 2, të nenit 41, të ligjit nr.111/2012, “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim për dhënien me koncension të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujrave të pëdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Vjosë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujor nëntokësorë për ujë të ambalazhuar në rastin kur përdorimi është për > 151 shishe/orë, > 1 l/sek, të subjektit “DG” sh.p.k, me vendndodhje: Fshati Tatzat, Njësia Administrative Vergo, Bashkia Delvinë, Qarku Vlorë.
2. Treguesit paraprakë janë si më poshtë:
Vendndodhja e burimit (KRGJSH):
X= 494622.6 Y= 4432863.6 Z=234.6 m.m.n.d
Vendndodhja e pikës ku do të shfrytëzohet uji (KRGJSH):
X= 494904.9 Y= 4432414 Z=216 m.m.n.d
Sasia e ujit të kërkuar: Q= 5 l/sek
Prurja mesatare vjetore: Qmes-vj= 9 l/sek
Lloji aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret ujit. Për ujë të ambalazhuar.

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH):

X= 494892.4 Y= 4432322.8 Z=215 m.m.n.d

Prurja që shkarkohet: Q= 2 l/sek

Trupi ujqor pritës: Përroi Tatzatit

3. Subjekti duhet të marrë masa për sigurimin e zonës së mbrojtjes sanitare të burimit dhe depove përpara fillimit të shfrytëzimit të tij për ambalazhimin e ujit.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektit.



KRYETAR

FLAMUR MAMAJ